

VENDIM
Nr.131, datë 3.2.2008

**PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE, PYJE DHE KULLOTA,
QË DO TË TRANSFEROHEN NË PËRDORIM TË NJËSISË SË QEVERISJES VENDORE,
KOMUNA SHEZË TË QARKUT TË ELBASANIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 2, 3 e 17, të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, dhe të nenit 23 të ligjit nr.9385, datë 4.5.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave dhe të Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, pyje dhe kullota, që janë në juridiksionin, territorial dhe administrativ, të njësisë së qeverisjes vendore, komuna Shezë të qarkut të Elbasanit, që do t’i transferohen në përdorim kësaj njësie.

2. Lista përfundimtare e pronave të paluajtshme, pyje dhe kullota, me 1 (një) fletë e që përfundon me numrin rendor 9 (nëntë), dhe lidhja nr.1, i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse e tij.

3. Ngarkohen Ministria e Brendshme, Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë dhe njësia e qeverisjes vendore, komuna Shezë, të qarkut të Elbasanit, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

2. FORMULAR I LISTES PERFUNDIMTARE TE TRANSFERIMIT TE PRONAVE TE PALUAJTESHME SHETERORE (sipas inventarizimit te pronave te vecanta te tipit pyje, kullota, livadhe, shkembore, etj.)

Institucioni i Pushtetit Qendror: M.M.P.A.U.									
Komuna: Shezë									
Nr. i prones sipas VKM	Emertesa e ekonomise pyjore dhe kullosore (PPK) Shtrirja gjeografike PPK	Emertesa e ngastres Vendndodhja (sipas emerteses popullore)	Numri i ngastres	Destinacioni	Siperfaqja ne ha	Funksioni per te cilen perdoret prona	Institucioni me pergjegjesi administrative	Institucioni / Enti perdorues Statusi Juridik i perdorimit	Te dhena te tjera
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10
190	EP Rrase - Xherije	Gorza	3/a	Pyl	3,00	Prodhues	M.M.P.A.U.	D.SH.P. Peqin	
191	EP Rrase - Xherije	Pylli Beut	4	Pyl	30,30	Prodhues	M.M.P.A.U.	D.SH.P. Peqin	
192	EP Rrase - Xherije	Faqja borishtit	5a	Pyl	71,90	Prodhues	M.M.P.A.U.	D.SH.P. Peqin	
194	EP Rrase - Xherije	Faqja Krames	7/b	Pyl	20,00	Prodhues	M.M.P.A.U.	D.SH.P. Peqin	
195	EP Rrase - Xherije	Malduka	8/a	Pyl	32,00	Prodhues	M.M.P.A.U.	D.SH.P. Peqin	
196	EP Rrase - Xherije	Faqja Murrizit	8/b	Pyl	19,20	Prodhues	M.M.P.A.U.	D.SH.P. Peqin	
197	EP Rrase - Xherije	Dushku kuq	9/a	Pyl	51,80	Prodhues	M.M.P.A.U.	D.SH.P. Peqin	
198	EP Zalli Shkumbin	Z. Sheze madhe	5	Pyl	36,30	Prodhues	M.M.P.A.U.	D.SH.P. Peqin	
199	EP Zalli Shkumbin	Z. Sheze vogel	6	Pyl	4,00	Prodhues	M.M.P.A.U.	D.SH.P. Peqin	

Njësia e Qeverisjes Vendore Komuna Shezë

Lidhja 1

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
190 – 192;	Pyje, kullota	Në përdorim
194 – 199.	Pyje, kullota	Në përdorim